

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6722
E martë, 4 tetor 2022
çmimi 0.40 €

Kuvendi miraton zgjatjen e masave emergjente për rrymë

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MËSIMI FILLOI, POR QEVERIA NUK UA DHA PAGAT GREVISTËVE TË ARSIMIT

FAQE 4-5



Viti i ri shkollor ka nisur zyrtarisht të hënën në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Fillimi i mësimt ka ndodhur me një vonesë prej një muaji si rezultat i një greve të mësimdhënësve e cila është pezulluar deri në janar. Por ky fillim i procesit mësimor

nuk shkoi si duhet, pasi qeveria nuk ua dha pagat për muajin shtator grevistëve të arsimit. Kryetari i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK), Rahman Jasharaj, ka paralajmëruar situatë të tensionuar nëse ekzekutimi i pagave nuk bëhet deri më 5 tetor

KËTË VIT MBI 4 100 STUDENTË TË RINJ I JANË BASHKUAR UP-së

FAQE 3



SPECIALJA DORËZON AKTAKUZËN E NDRYSHUAR NDAJ THAÇIT, VESELIT, KRASNIQIT DHE SELIMIT

FAQE 3

AKTUALE



ÇEKIA U BËN THIRRJE QYTETARËVE TË SAJ TË LARGOHEN NGA RUSIA

F. 2

NË KOSOVË SHËNOHET DITA BOTËRORE E PERSONAVE TË MOSHUAR

F. 7

SUEDEZI SVANTE PAABO FITON ÇMIMIN NOBEL PËR MJEKËSI

F. 7

EKONOMI



KEDS-i NIS LEXIMIN E NJEHORËVE ELEKTRIKË ME PAJISJE TË RE TË DORËS

F. 8

MALI I ZI KËRKON THELLIM TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK DHE TREGTAR ME KOSOVËN

F. 8

SPORT



INTERI KËRKON KËNDËLLJEN NDAJ BARÇËS SË FRIKSHME

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Çekia u bën thirrje qytetarëve të saj të largohen nga Rusia

PRAGË, 3 TETOR - Republika Çeke ka lëshuar një paralajmërim për qytetarët e saj për t'u larguar nga Rusia pasi Moskë shpalli mobilizimin ushtarak muajin e kaluar.

Qeveria çeke edhe më herët kishte paralajmëruar kundër udhëtimit në Rusi dhe në shkurt, kur Rusia nisi pushtimin e Ukrainës, u kishte bërë thirrje shtetasve të saj të largohen nga vendi.

Më 3 tetor Ministria e Jashtme çeke zgjeroi thirrjet e saj, duke thënë se çekët që janë të pajisur me shtetësi ruse përballen me

rreziqe pas shpalljes së mobilizimit nga Rusia në shtator, tha një zëdhënëse e kësaj ministrie. "Qytetarët e Republikës Çeke që, po ashtu, janë të pajisur me shtetësi ruse, duhet të dinë se nëse ata janë në territorin e Federatës Ruse, ata shihen nga autoritetet ruse si shtetas të Federatës Ruse", tha Ministria e Jashtme çeke përmes deklaratës së publikuar në uebfaqen e saj. "Ambasada çeke në Moskë nuk mund t'ofrojë mbrojtje adekuate dhe të plotë konsullore të gjithë këtyre shtetasve", u tha në njoftim. Çekia, po ashtu, paralajmëroi se

shtetasit e saj, që kanë edhe shtetësi ruse, mund të pengohen që të përdorin në Rusi kartelat bankare të lëshuara nga Republika Çeke për shkak të sanksioneve.

Republika Çeke ka qenë një nga mbështetëset më të mëdha të Ukrainës së cilës i ka dërguar ndihmë ushtarake dhe, po ashtu, ka pranuar qindra mijëra refugjatë ukrainas.

Praga, po ashtu, ka ndaluar lëshimin e vizave për rusët, përveç për raste humanitare, pasi Rusia nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt.



Polonia kërkon 1.3 trilion dollarë reparacione nga Gjermania



VARSHAVË, 3 TETOR - Ministria e Jashtme e Polonisë ka nënshkruar një notë zyrtare për Gjermaninë më 3 tetor, duke i kërkuar pagesën prej 1.3 trilion dollarësh në reparacione për dëmet e shkaktuara nga forcat pushtuese naziste gjermane gjatë Luftës së Dytë Botërore. Ministri i Jashtëm polak, Zbigniew Rau, tha se nota zyrtare do t'i dërgohet Ministrisë së Jashtme gjermane. Nënshkrimi i kësaj letre vjen pak para takimit të Rau në Varshavë me ministren

e Jashtme gjermane, Annalena Baerbock, e cila do të marrë pjesë në një konferencë të sigurisë.

Rau tha se kërkesa e shprehur përmes kësaj note shpreh qëndrimin se të dyja palët duhet të marrin veprime "pa vonesa" për t'i adresuar efektet e pushtimit gjerman të viteve 1939-45, "në mënyrë afatgjatë dhe komplekse, përmes një forme ligjore dhe materiale".


Ai tha se ky proces do t'i përfshinte reparacionet e Gjermanisë, por edhe zgjidhjen

e çështjes së veprave të vjedhura të artit dhe arkivave.

Qeveria e krahut të djathtë në Poloni insiston se shteti duhet të marrë reparacionet për shkak të dëmeve të mëdha të luftës, ndërkaq Berlioni thotë se u ka paguar kompensime shteteve të prekura, përfshirë Poloninë dhe Gjermania e konsideron këtë çështje të mbyllur.

Në përvjetorin e 83-të të luftës më 1 shtator, qeveria polake prezantoi një raport të gjerë të dëmeve, që tha se kapin vlerën e 1.3 trilion dollarëve.

Pas rrjedhjeve në Baltik, Norvegjia dërgon ushtarë në uzinat e naftës dhe gazit



Oslo, 3 tetor - Ushtria norvegjeze ka njoftuar të hënën se ka dërguar ushtarë për të ndihmuar në ruajtjen e impianteve kryesore të përpunimit të naftës dhe gazit. Kjo është pjesë e një përpjekjeje më të gjerë për ta rritur nivelin e sigurisë mes dyshimeve se sabotimi shkaktoi rrjedhje në tubacionet e gazit Rrjedha Veriore.

Katër rrjedhje - dy në zonën e Danimarkës dhe dy në zonën e Suedisë - janë zbuluar javën e kaluar në dy tubacione të mëdha ruse, Rrjedha Veriore 1 dhe Rrjedha Veriore 2.

Norvegjia, furnizuesja më e madhe e gazit në Evropë dhe një eksportuese e madhe e naftës, javën e kaluar vendosi flotën e saj dhe forcat ajrore për t'i patrulluar zonat e naftës në

det të hapur dhe njoftoi se për ta bërë këtë do të merrte ndihmë nga Britania, Gjermania dhe Franca.

Me kërkesë të policisë norvegjeze, Garda e Shtëpisë Norvegjeze, një forcë e mobilizimit të shpejtë, filloi të hënën të vendosë trupa në uzinat përgjegjëse për përpunimin dhe eksportimin e naftës dhe gazit.

GERB prin në zgjedhjet në Bullgari

SOFIJE, 3 TETOR - Partia bullgare e qendrës së djathtë, GERB, e ish-kryeministrit Boyko Borissov, pritet t'i fitojë zgjedhjet në Bullgari, të katërtat në më pak se dy vjet. Megjithatë, mundësitë për të formuar koalicion qeveritar mbesin të paqarta. Pas numërimit të 99 për qind të votave, autoritetet kanë thënë se GERB ka fituar

25.4 për qind të votave. Rivalja kryesore, partia reformiste, Ne vazhdojmë ndryshimin, e Kiril Petkovit, ka dalë e dyta me 20.2 për qind.

Këto rezultate çojnë në bisedime të vështira për koalicion në një parlament të ndarë.

Ka rrezik që shteti të shkojë sërish në zgjedhje të parakohshme.

Secili prej këtyre skenarëve do të mund ta zgjasë jostabilitetin në kohën e krizës së energjisë dhe rritjes së çmimeve të konsumatorëve.

Një situatë e tillë mund t'i dëmtojë edhe përpjekjet e Bullgarisë që më 2024 të bëhet pjesë e Eurozonës.

Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve pritet të bëhen publike të enjten.



Kuvendi miraton zgjatjen e masave emergjente për rrymë

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 3 TETOR - Me 61 vota për, Kuvendi i Kosovës ka miratur kërkesën e qeverisë për t'i zgatur masat emergjente për furnizim me energji edhe për një muaj. Partitë opozitare bojkotuan votimin e kësaj mase të qeverisë, pasi paraprakisht seanca ishte shtyrë për shkak të mungesës së kuorumit, për shkak se në të njëjtën kohë po mbaheshin mbledhjet e dy komisioneve parlamentare. Opozita ishte kundër shtyrjes së seancës, por kur rinisi seanca ata nuk morën pjesë në votimin për masat emergjente. Ekzekutivi më herët ka thënë se zgjatja e masave emergjente bëhet për "normalizimin e plotë" të gjendjes me rrymë.

"Zgjatja e këtyre masave bëhet për shkak të rritjes së kërkesës për energji dhe gjendjes jostabile të furnizimit me energji elektrike", thuhej në njoftimin e qeverisë të

marrë më 23 shtator.

Qeveria e Kosovës ka paralajmëruar se vendi do të përballet me një dimër të vështirë për shkak të krizës së energjisë që ka mbërthyer Evropën - të shkaktuar nga pushtimi i paprovokuar rus i Ukrainës - dhe rritjes së çmimeve të importit të energjisë.

Në muajin gusht, kur Kosova u përball me reduktime të energjisë, qeveria miratoi masat emergjente që përfshinin masat e kursimit të energjisë elektrike nga të gjitha institucionet, ndalimin e përdorimit të rrymës për mihjen e kripovalutave dhe mbështetjen e Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Tregut (KOSTT), që ky operator t'i ndërmarrë masat e duhura për të ofruar siguri të sistemit elektro-energetik. Ndërkaq, më 20 shtator, ekzekutivi ndaloi eksportin dhe riekportin e produkteve të drurit që përdoren si lëndë djegëse.

Autoritetet thonë se Kosova nuk



mund ta mbulojë kërkesën me rrymë gjatë dimrit me prodhimin e dy termocentraleve në Obiliq.

Termocentralet Kosova A dhe B mund të prodhojnë rrymë deri në 800 megavat, por nevojat e

konsumatorëve gjatë dimrit arrijnë deri në 1 300 megavat në orë.

Këtë vit mbi 4 100 studentë të rinj i janë bashkuar UP-së

EPOKA
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 3 TETOR - Në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" të hënën ka nisur viti i ri akademik 2022/23. Mbi 4 100 studentë të rinj i janë bashkuar UP-së këtë vit, në dhjetëra programe studimore, të ofruara në 14 njësi akademike. Universiteti i Prishtinës edhe sivjet ka vazhduar tërheqjen e studentëve të shkëlqyer. Mbi 45 për qind të studentëve të pranuar në UP në vitin e parë të studimeve themelore kanë sukses të shkëlqyer, gjatë shkollës së mesme, me mesatare 5.0.

Me fillimin e vitit të ri akademik, rektori i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", prof. dr. Naser Sahiti, ka përgëzuar brucoshët, studentët që vijnë në studimet në të gjitha drejtimet e UP-së, stafin akademik e administrativ për punën e tyre si dhe partnerët për bashkëpunimin e tyre. "Universiteti ynë po e nis edhe një vit akademik, si shtëpia e re e ish-nënësve me sukses të dalluar. Mbi 60 për qind e studentëve, që sot kanë nisur studimet në UP, kanë



sukses të shkëlqyeshëm (notë mesatare mbi 4.5) në shkollimin e mesëm. Ky fakt konfirmon se universiteti ynë vazhdon të jetë zgjedhja e parë e të rinjve ambiciozë të cilët dëshirojnë të sfidohen dhe të jenë pjesë e institucionit lider në vend dhe të përgatiten akademikisht në

programet studimore prestigjioze që ofron ky institucion", ka thënë Sahiti.

Ai ka theksuar se UP-ja që nga themelimi i tij shquhet për studimet cilësore dhe për faktin që në bankat e këtij universiteti janë përgatitur kuadrot kryesore të këtij vendi. "Shoqëria e sotme është UP-

ja dhe shoqëria e së nesërme do të jeni ju! UP-së këtë vit akademik i janë bashkuar mbi 4 mijë studentë të rinj në studimet themelore, ndërkaq jemi në proces të rekrutimit të studentëve në studimet master dhe të doktoratës", ka deklaruar rektori Sahiti.

Ai ka shtuar se tetori, pos që shënon fillimin e vitit të ri akademik në vendin tonë, është edhe pjesë e pashlyeshme e historisë, edhe falë ngjarjeve të vitit 1997, kur më 1 tetor të atij viti UP-ja u shfaq në skenë si aktori kryesor në kthesën më të madhe historike për Kosovën. "Sikurse para një çerekshkulli, ashtu edhe sot, UP-ja është orientues dhe baza kryesore e përgatitjes intelektuale të vendit tonë. E thëna e para 25 vjetëve e rektorit Ejup Statovci, se 'Universiteti është me studentët dhe studentët janë të universitetit' vazhdon të jetë udhëzuese e ideologjisë së UP-së. Pra, Universiteti i Prishtinës është madhështor, sepse të tillë e bëjnë studentët e tij. UP-ja, përveç lidhshimit të pakontestueshëm në vend për përgatitje akademike të të rinjve brenda 14 njësi akademike të tij, ofron mundësi të diplomave të dyfishta me universitete partnere jashtë vendit dhe mundësi të shkëmbimeve akademike në universitete botërore", ka thënë Naser Sahiti, rektor i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Osmani pranon letrat kredenciale nga ambasadori jorezident i Tajlandës

PRISHTINË, 3 TETOR - Presidentja Vjosa Osmani ka pranuar letrat kredenciale nga ambasadori jorezident i Tajlandës, Nipon Petchpornprapas, të cilit i ka uruar mirëseardhje. Në takim është diskutuar për marrëdhëniet bilaterale si dhe zhvillimet politike në Kosovë,

rajon e më gjerë.

Presidentja Osmani ka vlerësuar se Tajlanda është një partnere e fortë bilaterale dhe aleate e Kosovës dhe e ka falënderuar ambasadorin për mbështetjen e deritashme nga shteti i tij.

Sipas presidentes, Kosova është

e interesuar për forcimin e marrëdhënieve tregtare me Tajlandën.

Presidentja Osmani dhe ambasadori Petchpornprapas në takim kanë diskutuar edhe për thellimin e raporteve në sfera të ndryshme, përfshirë tregtinë, turizmin, kulturën.





Mësimi filloi, por qeveria nuk ua dha pagat grevistëve të arsimit

Viti i ri shkollor ka nisur zyrtarisht të hënën në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Fillimi i mësimit ka ndodhur me një vonesë prej një muaji si rezultat i një greve të mësimdhënësve e cila është pezulluar deri në janar. Por ky fillim i procesit mësimor nuk shkoi si duhet pasi qeveria nuk ua dha pagat për muajin shtator grevistëve të arsimit. Kryetari i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK), Rahman Jasharaj, ka paralajmëruar situatë të tensionuar nëse ekzekutimi i pagave nuk bëhet deri më 5 tetor

kundërshtim me ligjin. Ai ka thënë se shteti do të duhej të paguante 1 500 euro për secilin grevist nëse ata do ta paditin Ministrinë e Financave në gjykatën kompetente. "Mosekzekutimi i pagave për grevistët është në kundërshtim me ligjin. Është persekutim ndaj grevistëve. Përndryshe, secili grevist që paraqet padi në gjykatë, përveç

pagës, pastaj do të kompensohet edhe me shpenzimet e avokatit dhe kamatën ligjore. Me fjalë të tjera, nga një pagë që mund të jetë 480 euro për një muaj, shteti do të paguajë diku 1 500 euro. Në fund faturën e paguan taksapaguesi. P.s.: Leximi i ligjit dhe interpretimi i ligjit dallon", ka shkruar Miftaraj në "Facebook".

Këshilli i Prindërve ka kërkuar nga

Qeveria e Kosovës që t'i ekzekutojë pagat e mësimdhënësve për muajin shtator. "Grevat në arsimin e obligueshëm duhet të rregullohen me ligj dhe jo me forma të tjera 'disiplinimi'", është thënë në reagimin e Këshillit të Prindërve. Deputeti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Armend Zemaj, ka reaguar në lidhje me

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 TETOR - Kryetari i Sindikatës së Bashkuar për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (SBASHK), Rahman Jasharaj, ka bërë me dije të hënën se shërbyesve civilë, të cilët kanë qenë pjesë e grevës, u janë ekzekutuar pagat për muajin shtator, por kjo nuk ka ndodhur edhe për sindikalistët e arsimit. "Te sistemi arsimor nuk janë ekzekutuar, kurse për shërbyesit civilë po, ne nuk jemi kundër ekzekutimit për ta, por nuk është mirë të bëhet kjo ndarje, dhe nëse ndodh që deri më 5 tetor të mos alokohen pagat, do të kemi situatë të tensionuar", thotë ai.

Ndërkaq Ali Gashi, kryetar i Sindikatës së Punëtorëve në Administratë Publike, ka konfirmuar se pagat e tyre janë

ekzekutuar. Por, Qeveria e Kosovës thotë që pagat janë ekzekutuar vetëm për zyrtarët të cilët kanë dalë në punë. "Për muajin shtator pagesat në sektorin publik janë ekzekutuar për zyrtarët të cilët kanë dalë në punë dhe kanë kryer detyrat dhe përgjegjësitë e tyre. Paga mujore është kompensim për punë. Në raste të grevave, kjo çështje përcaktohet në Ligjin për Greva", ka thënë Përparim Kryeziu, zëdhënës i Qeverisë së Kosovës.

Neni 18 i Ligjit për Greva thotë se gjatë zhvillimit të grevës pezullohen detyrimet që rrjedhin nga kontrata e punës, duke përfshirë të drejtën në pagesë dhe detyrimin e bindjes për të punuar. Drejtori i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), Ehat Miftaraj, ka thënë se mosekzekutimi i pagave për grevistët është në



Specialja dorëzon aktakuzën e ndryshuar ndaj Thaçit, Veselit, Krasniqit dhe Selimit

HAGË, 3 TETOR - Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë kanë njoftuar se, bazuar në vendimet e gjyqarit të procedurës paraprake, të datës 22 korrik 2022 dhe 29 shtator 2022, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka dorëzuar aktakuzën e ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit.

Gjykatësi paraprak më 29 shtator miratoi kërkesën e Prokurorit të Specializuar për tërheqjen e pretendimeve për krime në komunën e Ferizajt. Ndërsa gjykatësi kishte aprovuar pjesërisht mocionin e mbrojtjes të Hashim Thaçit të parashtruar ndaj aktakuzës së ndryshuar në rastin ku ai me Kadri Veselin, Jakup Krasniqin e Rexhep Selimin, po akuzohen për krime lufte dhe ZPS ishte urdhëruar të bënte ndryshime në aktakuzën e ndryshuar. Sa i përket kësaj, ZPS-ja u urdhërua ta dorëzonte deri më 30 shtator aktakuzën e ndryshuar.

Në njoftimin e DSK-së thuhet se më 22 korrik gjykatësi i procedurës paraprake miratoi pjesërisht kërkesën e mbrojtjes të Thaçit që pretendon mangësi në aktakuzën e fundit kundër të akuzuarve në këtë çështje gjyqësore, e dorëzuar më 29 prill 2022. "Gjykatësi Giju urdhëroi ZPS-në që deri më 30 shtator 2022 ta dorëzojë aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar më tej, me një numër informacionesh shtesë lidhur me akuzat aktuale. Hollësitë lidhur me shtesat mund t'i gjeni në vendimin aktual", thuhet në njoftim.

Më 29 prill Zyra e Prokurorit të Specializuar dorëzoi një aktakuzë të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Prokuroria po pretendon se katër të akuzuarit kanë kryer krime lufte edhe në Gjilan, Budakovë dhe Semetishtë.

Në aneksin e publikuar sa iu përket krimeve që pretendohen

se ndodhën në Semetishtë dhe Budakovë, prokuroria ka listuar krimet e luftës si arrestimi dhe ndalimi i paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor ose çnjerëzor, torturë, vrasje. Ndërkaq, si krime kundër njerëzimit i ka listuar burgimin, vepra të tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen, zhdukjen e personave me forcë dhe persekutimin.

Kurse për krimet që pretendon që ndodhën në Gjilan, si krime lufte i ka listuar arrestimin dhe ndalimin e paligjshëm ose arbitrar, trajtimin mizor ose çnjerëzor, torturën dhe vrasjen. Ndërsa si krime kundër njerëzimit ka listuar burgimin, vepra të tjera çnjerëzore, torturën, vrasjen dhe persekutimin.

Më 9 nëntor të vitit 2020, në paraqitjet e tyre të para, Jakup Krasniqi e Hashim Thaçi janë deklaruar të pafajshëm për akuzat. Në të njëjtën mënyrë është deklaruar edhe Veseli më 10 nëntor, sikurse edhe Selimi

më 11 nëntor.

Aktakuza ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit është konfirmuar më 26 tetor 2020. Sipas akuzës, të paktën midis marsit 1998 deri në shtator 1999, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi dhe anëtarë të tjerë kishin qëllimin e përbashkët për të siguruar dhe ushtruar kontroll mbi të gjithë Kosovën përmes metodave që përfshinin frikësimin, keqtrajtimin, ushtrimin e dhunës dhe eliminimin e paligjshëm të atyre që konsideroheshin si kundërshtarë. "Ndër këta kundërshtarë përfshiheshin persona që ishin, ose që konsideroheshin se kishin qenë: (a) bashkëpunëtorë ose të lidhur me forca, zyrtarë ose institucione shtetërore të RFJ-së, ose që (b) ndryshe nuk mbështetnin qëllimet ose metodat e UÇK-së dhe më vonë të QPK-së, ndër të cilët persona

të lidhur me LDK-në dhe serbë, romë dhe persona të kombësive të tjera (bashkërisht, 'kundërshtarët'). Ky qëllim i përbashkët përfshinte krimet e përndjekjes, burgosjes, arrestimit dhe ndalimit arbitrar ose të paligjshëm, akte të tjera çnjerëzore, trajtimin mizor, torturën, vrasjen dhe zhdukjen me forcë të personave", thuhet në aktakuzë.

Në aktakuzë përmenden edhe Azem Syla, Lahi Brahimaj, Fatmir Limaj, Sylejman Selimi, Rustem Mustafa, Shukri Buja, Latif Gashi dhe Sabit Geci.

"Si alternativë, disa ose të gjithë këta individë nuk ishin anëtarë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët, por u përdorën nga anëtarë të ndërmarrjes kriminale të përbashkët për të kryer krime për realizimin e qëllimit të përbashkët (së bashku me anëtarët e NKP-së, bashkërisht 'anëtarët dhe instrumentet e NKP-së')", thotë akti akuzues. /Kosovapress



mosekzekutimin e pagave për mesimdhënësit për muajin shtator.

Zemaj e ka quajtur regjim të kuq qeverisjen e Lëvizjes Vetëvendosje. Sipas tij, për herë të parë në Kosovën e lirë, siç shkruan ai, regjimi i kuq i dënoi mesimdhënësit grevistë me ndalje të pagës. "Regjimi i kuq, injorues, dëshitues dhe dënues. Sot, për herë të parë në Kosovën e lirë, regjimi i kuq i dënoi mesimdhënësit grevistë me

ndalje të pagës. Në vend të urimit për një fillim të mbarë të vitit shkollor, edhe pse të vonuar pikërisht nga qeverisja e paaftë dhe grindavece, mësuesit po privohen nga të drejtat e tyre elementare, ngase po iu ndalet buka e gojës. Regjimi i kuq, nxënësit i dënoi me humbje të mësimit, prindërit me ç'rregullim të organizimit familjar, ndërsa mësuesit me ndalje të bukës së gojës. Regjimi i kuq nuk është zgjidhje, sepse për

krejt është i padrejtë", ka shkruar Zemaj në "Facebook".

Nxënësit kthehen në shkolla

Viti i ri shkollor ka nisur zyrtarisht të hënën në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar në Kosovë. Fillimi i mësimit ka ndodhur me një vonesë prej një muaji si rezultat i një greve të mesimdhënësve e cila është pezulluar më 1 tetor deri në

janar.

Greva në arsim dhe në administratën publike, në nivelin lokal dhe qendror, ka nisur më 25 gusht të këtij viti.

Greva është pezulluar pas votimit të anëtarësive të sindikalistëve. Sindikalistët kanë mbajtur grevën me kërkesë kyçe për ndarje të 100 eurove për punëtorë, për çdo muaj, deri në hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga. Qeveria, në anën tjetër, ka publikuar një pako për ndihmë

për shkak të rritjes së inflacionit - dhe në të janë ndarë edhe nga 50 euro për të gjithë punëtorët e sektorit publik.

Qeveria së fundmi ka hartuar Projektligjin për Paga dhe i njëjti është në procedura të konsultimeve publike. Ai më pas duhet të miratohet në Qeveri dhe Kuvend, më pas të publikohet në Gazetën Zyrtare. Tetë muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare, ky legjislacion pritet të hyjë në fuqi.

Shpërndahen arkat Lr dhe fletët e dyllit për fermerët bletarë në Kamenicë

KAMENICË, 3 TETOR - Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Kamenicë ka bërë shpërndarjen e Arkave Lr

dhe Fletëve të Dyllit për fermerët bletarë. Ky projekt "Furnizimi i fermerëve bletarë me Arka Lr dhe Fleta Dylli" është

projekt i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në participim nga ana e fermerëve me 30 për qind.

Nga ky projekt kanë përfituar 14 bletarë, ku secili prej tyre ka përfituar 5 arka Lr dhe 10 kilogramë fleta dylli.



Në Prishtinë mbahet Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon, diskutohet për projekte të ndryshme

PRISHTINË, 3 TETOR - Prishtina ishte nikoqire e mbledhjes së anëtarëve të Unionit të Bashkive Shqiptare në Rajon në të cilën janë mirëpritur kryetarët dhe përfaqësuesit e drejtorive përkatëse të komunave dhe bashkive anëtare të Unionit.

Me moton "Kurorat e qyteteve shqipfolëse si destinacion i agroturizmit", diskutuam për mundësitë e bashkëpunimit të ndërsjellë në këtë drejtim. "Projekte të shumta janë realizuar deri më tani në kuadër të UBShR-së dhe shumë të tjera presin realizimin në të ardhmen e afërt, për të cilat u zotuar se bashku në këtë takim. Të mirat që ofron natyra janë të

pazëvendësueshme për shëndetin fizik e mendor të qytetarëve tanë. Andaj, çfarëdo lloj investimi që e ruan, promovon dhe e sjell natyrën më afër nesh, e që vepron në harmoni të plotë pa e dëmtuar atë është vlerë e shtuar shoqërore për të gjitha trevat shqipfolëse kudo", ka thënë kryetari i Prishtinës, Përparim Rama. Ndërkaq kryetari i Prizrenit, Shaqir Totaj, ka thënë se me trashëgiminë historike dhe kulturore, popullsinë shumëmetrike, por edhe bukurinë e qytetit e bashkëpunimit të natyrës me të gjitha asetet, Prizreni ka potencial të zhvillimit edhe më të madh të turizmit.



Drejtoria për Shëndetësi në Mitrovicë merr donacion nga "Jetimat e Ballkanit"



MITROVICË, 3 TETOR - Drejtoria për Shëndetësi në Mitrovicë ka pranuar një donacion me pajisje mjekësore nga Shoqata Bamirëse "Jetimat e Ballkanit", donacion ky i cili do të shfrytëzohet për nevojat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare "Dr. Nexhat Çuni". Ky donacion përmban 20 shtretër spitalorë, 10 karroca invalide, 30 shëtitore për pacientë, 3 karrige ndihmëse për pastrim, 10 ulëse të karrocave invalide si dhe 10 pako me kollostoma. Me këtë rast, drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi, Fahri Shabani, ka falënderuar Shoqatën Bamirëse "Jetimat e Ballkanit" për dhurimin e këtij donacioni të

rëndësishëm për shëndetësinë e Mitrovicës dhe bashkëpunimin e deritanishëm, duke u zotuar që ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Ai ka potencuar faktin se pajisjet e dhuruara do të ndihmojnë në lehtësimin e shërbimeve sa më të mira për qytetarët e komunës së Mitrovicës, ku një pjesë e këtij donacioni do të jepet në shfrytëzim për qytetarët të cilët nuk kanë mundësi të sigurojnë këto pajisje.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare "Dr. Nexhat Çuni" do ta vazhdojë punën me shërbime sa më cilësore dhe dinjitoze për të gjithë qytetarët e komunës së Mitrovicës.

Adelina Stublla emërohet drejtoreshë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Podujevë

PODUJEVË, 3 TETOR - Me vendim të kryetarit të komunës, Shpejtim Bulliqi, Adelina Stublla është emëruar drejtoreshë e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Podujevë.

Adelina Stublla ka qenë për tri mandate radhazi këshilltare e Kuvendit Komunal, ndërsa në këtë mandat ka qenë edhe shefe e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje në Kuvendin

Komunal. Pas emërimit të Stubllës në krye të këtij dikasteri, kryetari Bulliqi i ka uruar suksese në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi të saj.



Kryetari i Gjilanit: Kemi marrë masa për parandalimin e përmbytjeve si pasojë e reshjeve

GJILAN, 3 TETOR - Kryetari i komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, ka thënë se i kanë bërë të gjitha përgatitjet dhe i kanë marrë të gjitha masat

për parandalimin e përmbytjeve që mund të vijnë si pasojë e reshjeve të dendura që kjo stinë rëndom sjell. Ai ka njoftuar se

pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave ka nisur dhe po vazhdon nga Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim në pikat më të

ndjeshme që paraqesin rrezik permanent për qytetarët. "Jemi gjithmonë një hap para", ka thënë Hyseni.



Suedezi Svante Paabo fiton Çmimin Nobel për Mjekësi

STOKHOLM, 3 TETOR - Shkencëtari suedez Svante Paabo ka fituar Çmimin Nobel për Mjekësi për shkak të zbulimeve të lidhura me evolucionin njerëzor. Ky çmim, ndër më prestigjiozët në botën shkencore, është dhënë nga Asambleja për Nobel e Institutit Karolinska në Suedi dhe ka vlerën e 900.357 dollarëve amerikanë. Me Nobelin për Mjekësi nis sezoni i ndarjes së çmimeve Nobel në fusha të ndryshme,

përfshirë atë për paqe, letërsi, fizikë, kimi dhe ekonomi. "Ai ka mbetur pa fjalë, ka qenë shumë i lumtur", ka thënë Thomas Perlmann, sekretari i Komitetit të Nobelit në fushën e mjekësisë, i cili ia ka kumtuar Paabos lajmin. "Ai më ka pyetur nëse mund të ndante lajmin me dikë, nëse mund t'i tregonte dikujt, dhe unë i thashë se është në rregull. Ai ka qenë tej mase i gëzuar për këtë çmim". Paabo, djali i biokimistit Sune

Bergström po ashtu fitues i Çmimit Nobel, është vlerësuar për transformimin e studimit të origjinës njerëzore, duke krijuar qasje të tjera që mundësojnë analizimin e ADN-së nga gjurmët arkeologjike dhe paleontologjike. Në mesin e studimeve të tij përfshihet edhe ajo e një gjeni të neandertalëve, që shpërfaq lidhjen mes qenieve njerëzore që nuk ekzistojnë më dhe njeriut të ditëve të sotme.



Në Kosovë shënohet Dita Botërore e Personave të Moshuar

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 3 TETOR - Dita Botërore e Personave të Moshuar në Prishtinë u shënua me moton "Qëndrueshmëria dhe kontributet e grave të moshuara në një botë në ndryshim". Drejtori ekzekutiv i Institutit Kombëtar, Naser Ramadani, ka thënë se shënimi i Ditës Botërore të Personave të Moshuar ka për qëllim ngritjen e vetëdijes dhe ndërgjegjësimit për çështjet që prekin të moshuarit, ta tërheqë vëmendjen dhe t'i sfidojë stereotipat dhe keqkuptimet negative për të moshuarit dhe plakjen, t'u mundësohet të moshuarve ta kuptojnë potencialin e tyre, për ta

vlerësuar kontributin e të moshuarve në shoqëri si dhe për ta dëshmuar respektin ndaj tyre. "Ne si IKShPK ndihemi mirë që pas një kohe të gjatë të angazhimit të vazhdueshëm, për ngritjen e ndërgjegjësimit dhe të ndërmarrjes së veprimeve që lidhen me të moshuarit dhe kujdesin ndaj tyre, tashmë është e dukshme që aspektet që lidhen me këtë fushë janë gjithnjë e më të pranishme dhe të trajtuara edhe në opinionin publik edhe nga institucionet përgjegjëse në vendin tonë", ka thënë Ramadani. Zëvendësministrja e Shëndetësisë, Dafina Gexha, ka thënë se Ministria e Shëndetësisë do të vazhdojë ta zhvillojë programin e saj për një

kualitet më të mirë të shërbimeve shëndetësore, brenda të cilave të moshuarit edhe në të ardhmen do t'i kenë shërbimet falas, ndërkohë që, përmes Strategjisë së re të Shëndetësisë, sipas saj, rëndësi do t'u japin edhe fuqizimit të shërbimeve të kujdesit shtëpiak, përfshirë shërbimet e paliacionit. Përveç kësaj, ajo informoi se MSh-ja ka porositur vaksina të mjaftueshme për këtë kategori dhe se ata do të informohen së shpejti për kohën e vaksinimit, ndërkohë që edhe sot bën thirrje që të moshuarit t'i marrin dozat përforcuese të vaksinës kundër Covid-19. Përfaqësuese nga shoqata "Vita-Jeta", Rabije Slivova, ka theksuar

se aktivitetet e kësaj shoqate u shërbejnë grave të moshuara që të shoqërohen me njëra-tjetrën, të largohen nga problemet e përditshme dhe të vetëdijesohen për shëndetin e tyre me anë të ligjëratave dhe trajnimeve të ndryshme. Fahrrije Ajeti nga MFPT ka pohuar se kjo ministri të moshuarit i trajton në dy rrafshë: mbrojtja institucionale-rezidenciale dhe përkrahja financiare. Ajo ka theksuar se në Kosovë aktualisht janë pesë shtëpi të cilat ofrojnë shërbime dhe përkujdesje 24-orëshe për personat e moshuar pa përkujdesje familjare, të cilët janë edhe raste sociale. Sipas Ajetit, këto shtëpi janë në Skenderaj, Istog, Graçanicë dhe Novëbërdë.

Dr. Pranvera Krasniqi nga Qendra e Moshimit në IKShPK shpalosi një prezantim, me titull "Qëndrueshmëria dhe kontributet e grave të moshuara, në një botë në ndryshim", ku theksoi objektivat për vitin 2022. "Të nënvizohet qëndrueshmëria e grave të moshuara përballë pabarazive mjedisore, sociale, ekonomike dhe gjatë gjithë jetës. Të rritet ndërgjegjësimi për rëndësinë e përmirësimit të mbledhjes së të dhënave në mbarë botën, të ndara sipas moshës dhe gjinisë. T'u bëhet thirrje institucioneve dhe shoqërisë civile që t'i përfshijnë gratë e moshuara në qendër të të gjitha politikave, duke siguruar barazinë gjinore", ka thënë Krasniqi.

Enver Berisha rikthehet në AAK

Prishtinë, 3 tetor - Enver Berisha është rikthyer në Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK). "I dëshirova mirëseardhje në shtëpinë e vet, kolegut tonë shumëvjeçar Enver Berisha. Aleanca është e hapur për secilin që beson në vizionin dhe orien-

timin e saj atdhetar. Kolegët nga komuna e Klinës, që janë shembull për qeverisjen lokale në vend, i falënderova për kontributin dhe angazhimin e tyre të vazhdueshëm", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Berisha kohën e fundit ka

qenë pjesë e PDK-së në Klinë. Dega e PDK-së në këtë qytet ka njoftuar se Berisha është përfshirë nga partia për shkak se ka bërë pazare me AAK-në për të përfutur personalisht dhe familjarisht pozita udhëheqëse në qeverisjen lokale.



Mali i Zi kërkon thellim të bashkëpunimit ekonomik e tregtar me Kosovën

PRISHTINË, 3 TETOR - Marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Malit të Zi duhet të thellohen dhe zhvillohen me forma më të larta të bashkëpunimit për ekonomi dhe tregti, thotë Mladen Peraziq, drejtor i Sektorit të Edukimit në Odën malazeze të Ekonomisë. Peraziq ka thënë se kompanitë nga Mali i Zi janë të interesuara të investojnë në Kosovë dhe të realizojnë projekte të përbashkëta. Ai ka thënë se dy shtetet kanë potencial për investime, Mali i Zi për turizëm dhe Kosova në sektorë të ndryshëm. "Bashkëpunimi me komitetin e bizneseve dhe odat ekonomike kosovare është shumë i mirë. Ato kanë një traditë të gjatë bashkëpunimi duke marrë pjesë në shumë projekte të përbashkëta. Ne po bashkëpunojmë edhe në kuadër të Fondit të Ballkanit

Perëndimor (WBF). Është formë investimi e odave. Është themeluar disa vite më parë dhe përmes asaj po realizojmë shumë projekte për interesa të përbashkëta", ka thënë Peraziq. Drejtori në Odën Ekonomike në Mal të Zi, i cili mori pjesë në konferencën rajonale në Prishtinë të organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, ka thënë se aktivitetet e tilla janë një mundësi për t'i paraqitur ekonomitë e dy shteteve. "Kjo është një mundësi për të treguar aktivitetet tona dhe përkushtimin tonë në këtë proces, për ta përmirësuar bashkëpunimin ndërmjet komunitetit të biznesit të Malit të Zi dhe Kosovës. Kjo është një mundësi e mirë për të takuar njerëz, për t'i prezantuar ekonomitë e shtetit tonë dhe për ta ndihmuar bashkëpunimin", ka theksuar



ai. Raportet e fundit tregtare me vendet e CEFTA-s tregojnë se Kosova importoi 100 milionë

euro, kurse eksportoi 32 milionë. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-së janë Shqipëria me 14.8 për

qind, Serbia me 9.2 për qind, Maqedonia e Veriut me 8.4 për qind dhe Mali i Zi me 4.4 për qind. /Kp

KEDS-i nis leximin e njehsorëve elektrikë me pajisje të re të dorës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 TETOR - Me qëllim të avancimit të shërbimeve të leximit të njehsorëve elektrikë, KEDS-i ka vënë në funksion përdorimin e pajisjes më të re teknologjike të këtij lloji, e njohur si Unitech. Kjo pajisje zëvendëson pajisjen e vjetër "Hand Held Unit", që është në përdorim që nga viti 2014. "Përparësi e kësaj pajisjeje, në krahasim me pajisjen e vjetër, është futja e të dhënave shtesë në sistemin Android të saj, leximi i numrit të njehsorit përmes barkodit, përdorimi i kamerës, përdorimi i dy sim-kartelave 2G, 3G dhe 4G, si dhe printeri me Bluetooth i lidhur ndaras me të", thotë Flamur Kurtaj, menaxher për lexim, faturim dhe ndërrim të njehsorëve në



KEDS.

Pajisjet Unitech janë futur në përdorim pas trajnimit të stafit profesional për përdorimin dhe testimin e saj. E veçanta e kësaj pajisjeje është se, përveç që përkon me standardet më të larta teknologjike të këtij lloji,

përmirëson dukshëm edhe cilësinë në shërbim ndaj konsumatorit përmes leximit të saktë dhe të shpejtë të njehsorit, gjithnjë duke i minimizuar në masë të madhe gabimet e mundshme që mund të ndodhin në raste të tilla. Mbi

të gjitha, detekton edhe keqpërdorimet e mundshme. "Veçori e rëndësishme e kësaj pajisjeje është cilësia dhe shpejtësia për t'i lexuar njehsorët elektrikë. Në rast të ndonjë keqpërdorimi të mundshëm në njehsor, pajisja posedon edhe kamerën për fotografimin e njehsorit, për çka, në rast të tillë, lexuesi i informon personat përkatës në KEDS", thotë Milazim Avdiu, drejtor i Operimeve në KEDS.

Zhvillimi i aplikacionit për shërbim të leximit të njehsorit elektrik ka zgjatur rreth dhjetë muaj. Si i tillë, është një aplikacion i thjeshtë dhe i lehtë për t'u përdorur, ku mund të futen edhe të dhëna shtesë. "Varësisht prej nevojës, në aplikacionin Android të kësaj pajisjeje mund të shtohen

karakteristika të reja", thotë Shqipdon Mehmeti, zhvillues i aplikacioneve në Departamentin e IT-së në KEDS.

KEDS-i do të vazhdojë t'i kërkojë format më të sofistikuar për shërbimet ndaj konsumatorëve të tij dhe lehtësimin e punës së ekipeve të tij në terren.

Pajisja Unitech është pajisja e dytë në shfrytëzim për leximin e njehsorëve që kur KEDS-i ka filluar së operuari si kompani në vitin 2013.

Kompania KEDS menjëherë kishte revolucionarizuar mënyrën e leximit dhe të faturimit të konsumatorëve, duke e bërë elektronike dhe të atypëratyshme. Kjo kishte zvogëluar gabimet në lexim, shkurtuar kohën, kishte thjeshtësuar procedurat dhe kishte rritur ndjeshëm transparencën.

Inflacioni në Turqi, më i larti në 24 vjetët e fundit

ANKARA, 3 TETOR - Inflacioni vjetor në Turqi ka arritur në 83.5 për qind, shkalla më e lartë në 24 vjetët e fundit. Kjo situatë ka goditur konsumatorët që veçse po përballen me çmime të larta të energjisë dhe produkteve ushqimore. Instituti turk i Statistikave ka thënë se çmimet për konsumatorët janë rritur për 3.08 për qind për dallim nga muaji i kaluar. Ekspertët besojnë se inflacioni

është më i lartë sesa që paraqitet në statistikat zyrtare. Grupi i pavarur për Kërkime rreth Inflacionit ka thënë të hënën se inflacioni në Turqi ka shkuar në 186.27 për qind. Banka Qendrore e Turqisë ka zvogëluar edhe një herë normën e interesit pavarësisht prej rritjes së çmimeve. Lira turke ka humbur më shumë se 50 për qind të vlerës që ka kundrejt dollarit amerikan prej kur Banka Qendrore e Turqisë ka nisur t'i

ulë normat e interesit vitin e kaluar. Lufta e Rusisë në Ukrainë dhe rënia e vlerës së lirës kanë nxitur inflacionin në këtë shtet. Ekonomistët besojnë se në rritjen e inflacionit në Turqi kanë ndikuar edhe politikat e presidentit turk Rexhep Tajip Erdogan, i cili beson se ulja e normës së interesit ndikon në ulje të çmimeve, ndonëse teoritë ekonomike flasin për qasje të kundërt. Bankat qendrore në shumë



vende të botës, përfshirë ato në Shtetet e Bashkuara dhe Mbretërinë e Bashkuar, kanë

rritur së fundi normat e interesit me qëllim të luftimit të inflacionit.

Aneksimi i një pjese të Ukrainës nga Putini, një moment kritik për botën



Nga Alissa de CARBONNEL

Aneksimi i planifikuar nga Vladimir Putin i pjesëve të Ukrainës të pushtuara aktualisht nga Rusia, pas referendumeve të rreme që u zhvilluan atje pak ditë më parë, është më të paku një moment po aq i rrezikshëm në luftë, sa edhe spektakli televiziv maratonë që i parapriu pushtimin rus në shkurt.

Natyrisht, gjërat nuk kanë shkuar ashtu siç i kishte menduar Putin. Në shkurt, ai u përpoq ta justifikonte pushtimin me një fjalim plot mllef, të shoqëruar me terma juridike, dhe me një shfaqje të regjistruar paraprakisht të mbështetjes nga drejtuesit kryesorë të vendit.

E vetmja gjë e vërtetë në përpjekjen e Putinit për ta inkuadruar "operacionin special ushtarak" si diçka tjetër përveç një agresioni të hapur ndaj një vendi fqinj, ishin "udhëzimet" poshtëruese të Putin sesi duhej të fliste kreu i shërbimit sekret, Sergei Narishkin, që në një moment e injoroi skenarin e përgatitur duke u shprehur se e mbështeste bashkimin me Rusinë të republikave separatiste në Ukrainën Lindore.

Narishkin ishte gjysmë viti më herët dhe shumë i lig në ambicien e tij. Me pushtimin e saj, Rusia kishte planifikuar të rrëzonte me shpejtësi qeverinë në Kiev, të pushtonte një pjesë të madhe të

territorit, dhe të ushtronte ndikim të fortë mbi një Ukrainë të re miqësore me Moskën, ndoshta duke lënë atje një numër trupash. Por rezistenca e ashpër e Ukrainës, që kulmoi me rimarrjen e rrafshme të territorit në rajonin e Harkiv e ka shqetësuar shumë Kremlinin, duke e detyruar të nxitojë me zbatimin e planit B. Referendumet farsë në pjesët e kontrolluara nga Rusia në Donjeck, Luhansk, Herson dhe Zaporizhzhia – pararendëse të një aneksimi zyrtar të planifikuar këtë javë – ishin të nxituara dhe të shëmtuara.

Ato u mbajtën nën kërcënimin e armëve, dhe tekta aty pranë dëgjohej shpërthimi i predhave. Atyre u mungonte spektakli buratorik i të ashtuquajturave referendume të ngjashme që u zhvilluan në Krime në vitin 2014, të cilat u shoqëruan të paktën me përpjekjen për të joshur votuesit me premtime për pensione më të larta dhe investime ruse.

Këtë herë duke e pasur me urgjente, Kremlin duket se ka hequr dorë nga të gjitha formalitetet, duke zgjedhur brutalitetin. E pse duhet ta vrisnin mendjen për fasadën? Këto referendume kishin një axhendë të brendshme dhe ndërkombëtare. Dhe audiencia kryesore e Putinit është në Rusi.

Një ditë pas lajmeve për referendumet, ai urdhëroi mobilizimin e pjesëmështar, një lëvizje shumë jopopullore, të

cilën Rusia e kishte shmangur prej muajsh, pavarësisht mungesës së burimeve njerëzore në front. Fushatave ruse të keqinformimit nuk u është dashur gjithmonë të jenë të sofistikuar për të qenë të besueshme për një pjesë të popullsisë.

Por në këtë rast njerëzve që u kërkohet të vrasin ose të vdesin – ose të dërgojnë të dashurit e tyre për ta bërë këtë – janë më të prirur që të pyesin për arsyen. Me gjithë shtypjen e ashpër të Rusisë ndaj disidencës, protestat kanë shpërthyer në të gjithë vendin dhe të paktën 200.000 rusë janë larguar nga vendi që nga njoftimi i Putinit, shpesh duke shpenzuar gjithë kursimet e jetës për biletat e avionit që mezi gjenden, apo duke pritur një të rënë të lapsit, aneksimi synon ta transformojë konfliktin nga një "operacion special ushtarak" të largët dhe të kufizuar, dhe kur rusët mund të burgoseshin edhe vetëm nëse përdornin fjalën 'luftë', në një betejë për të mbrojtur territorin e Rusisë, dhe jo të Ukrainës.

Në nivel ndërkombëtar, objektivi tjetër është përshkallëzimi i përplasjes me mbështetësit perëndimorë të Ukrainës. Njoftimi i Putinit për mobilizimin, u shoqërua me kërcënimin esulmeve bërthamore nëse Ukraina do të vazhdojë të çlirojë territoret e pushtuara.

Putin po synon t'i bëjë të besueshme kërcënime të tilla,

duke imponuar kapitullimin. Po ashtu ato shërbejnë për të nxitur narrativën e rreme të luftës që po përhap Rusia përmes mediavesociale dhe diplomacisë dixhitale jashtë vendit. E gjithë kjo përbën një fazë të re të rrezikshme të luftës.

Ukraina po lufton për mbijetesën e saj. Ajo nuk është e shqetësuar për përshkallëzimin e luftës, dhe nuk ka ndërmend të tërhiqet. Mbështetësit e saj perëndimorë druhen me të drejtë se konflikti do të çojë në një përplasje NATO-Rusi. Por përpjekjet e Putin për të përshkallëzuar luftën në Ukrainën, do të nxisin shtimin e mbështetjes perëndimore, pikërisht në një kohë kur ajo rrezikonte të zbehej, tekta politikanët po përballen me problemet e inflacionit dhe energjisë.

Pra lufta do të vazhdojë. Putin e ka braktisur diplomacinë. Ndërsa atij i pëlqen t'i mbajë të hapura opsionet e tij, ato janë të kufizuara. Rusia mund të përgatisë forcat e saj për një sulm të ri në dimër. Nëse pushton territore të reja, mund të kërkojë përsëritjen e referendumeve të paligjshme atje. Dhe ajo që është edhe më alarmante, mund të zgjerojë objektivat e saj të goditjes në Ukrainë ose në një lëvizje të dëshpëruar, mund të veprojë kundër kërcënimit bërthamor të Putinit.

Udhëheqësit amerikanë dhe evropianë kanë absolutisht të drejtë që i cilësojnë kërcënime të

Moskës si një katastrofë të rrezikshme për vetë Rusinë, dhe i denoncojnë me shpejtësi referendumet si farsë.

Ky është një moment kritik për botën, përfshirë mediat dhe kompanitë e mëdha të teknologjisë, që duhet të dyfishojnë përpjekjet në kundërshtimin e fushatave ruse të keqinformimit. Edhe thjesht raportimi për referendumet sikur të jenë procese zgjedhore deri diku normale, rrezikon që t'i japë një lloj legjitimiteti.

Dhe në vend se t'i fajësojnë rusët, sidomos ata që kanë ikur nga Rusia për të mos u angazhuar në një luftë me të cilën nuk janë dakord, vendet evropiane duhet t'u ofrojnë atyre një strehë të sigurt. Pasi kjo e privon Moskën nga trupat, dhe përputhet me çdo parim humanitar.

Tek e fundit, shtetet perëndimore duhet të vazhdojnë të ecin në shtegun e ngushtë e të rrezikshëm, midis mbështetjes ndaj Ukrainës dhe përshkallëzimit të rrezikshëm të përplasjes me Rusinë. Sa më të rënda të jenë provokimet e Rusisë, aq më e rëndësishme do të jetë përgjigja me maturi, unitetit dhe vendosmëri, të cilat e kanë karakterizuar reagimin e Perëndimit deri më sot.

Shënim: Alissa de Carbonnel, zëvendës drejtore e programit për Evropën dhe Azinë Qendrore në Grupin Ndërkombëtar të Krizave. / "The Guardian" – Bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Interi kërkon këndelljen ndaj Barçës së frikshme

MILANO, 3 TETOR (ER) - Ndeshja kryesore sonte (e martë) në Ligën e Kampionëve zhvillohet në Grupin C në mes të Interit dhe Barcelonës në "San Siro". Këto dy skuadra kanë pikë të barabarta, pasi të dyja këto klube e kanë mposhtur Viktoria Plzenin, por kanë humbur ndaj Bayern Munchenit. Interi ka pasur një start jo të mirë në Serinë A, në anën tjetër Barcelona ka shkëlqyer duke qenë e pamposhtur në shtatë ndeshje dhe momentalisht është kryesues në La Liga me pikë të barabarta me Real Madridin. Rezultatet negative kanë vënë në pikëpyetje edhe të ardhmen e trajnerit Simone Inzaghi dhe mediet italianë raportojnë se nëse nuk merr fitore Interi në përballje me Barcelonën dhe në kampionat ndaj Sassuolos, trajneri italian do të shkarkohet. Në anën tjetër, kanë kaluar shtatë vjet që Barcelona nuk e ka fituar trofeun më të çmueshëm në futboll, por paraqitjet e kësaj skuadre në këtë edicion e kanë bërë ndër favoritët kryesorë për ta fituar Ligën e Kampionëve. Marcelo Brozović dhe Romelu Lukaku janë dy mungesat e Interit për këtë ndeshje, derisa Barcelona do të ketë shumë mungesa: Memphis Depay, Frenkie De Jong, Jules Kounde, Ronald Araujo dhe Hector Bellerin.



FORMACIONET E MUNDSHME:

Inter Milan: Handanović; Skriniar, Acerbi, Bastoni; Dumfries, Barella, Asllani, Calhanoglu, Dimarco; Martinez, Dzeko.
Barcelona: Ter Stegen; Roberto, Christensen, Garcia, Alba; Kessie, Busquets, Pedri; Dembele, Lewandowski, Raphinha.

GRUPI A	
21:00 Ajax - Napoli	
21:00 Liverpool - Rangers	
Tabela	
1. Napoli	Pikë 6
2. Liverpool	3
3. Ajax	3
4. Rangers	0
GRUPI B	
21:00 Club Brugge - Atletico Madrid	
21:00 Porto - Bayer Leverkusen	
Tabela	
1. Club Brugge	Pikë 6
2. Bayer Leverkusen	3
3. Atletico Madrid	3
4. Porto	0
GRUPI C	
18:45 Bayern Munchen - Viktoria Plzen	
21:00 Inter - Barcelona	
Tabela	
1. Bayern Munchen	Pikë 6
2. Barcelona	3
3. Inter	3
4. Viktoria Plzen	0
GRUPI D	
18:45 Marseille - Sporting CP	
21:00 Eintracht Frankfurt - Tottenham Hotspur	
Tabela	
1. Sporting	Pikë 6
2. Tottenham H.	3
3. Eintracht Frankfurt	3
4. Marseille	0

Trepça bëhet gati për organizim të Superkupës Mbarëkombëtare

Mitrovicë, 3 tetor - Klubi i Basketbollit Trepça do të jetë nikoqir i organizimit të Superkupës Mbarëkombëtare. Kjo ngjarje i është besuar klubit nga Mitrovica nga bordi i Ligës Unike dhe Federata e Basketbollit e Kosovës. Në këtë garë marrin pjesë kampionët dhe fituesit e kupave nga Superliga e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës. Të mërkurën nga ora 16:00, Teuta ballafaqohet me Tiranën, kurse në orën 19:00 Trepça e pret Golden Eagle Yllin. Fituesit e çifteve do të luajnë në finalen e madhe të enjten me fillim nga ora 20:00.



Purvis, MVP i javës së katërt



PRISHTINË, 3 TETOR - Në fundjavë u zhvillua xhiroja e katërt në elitën e basketbollit, ku u zhvilluan tri ndeshje. Peja regjistroi fitoren e katërt me radhë, duke mundur në udhëtim Vëllaznimin. Më i merituari për këtë fitore ishte

Rodney Purvis. Amerikani e përfundoi ndeshjen me 30 pikë, tri kërcime dhe katër asistime, duke e pasur indeksin 32. Purvis shënoi gjashtë trepikësha nga nëntë tentime. Ponte Prizreni ia shkaktoi humbjen e katërt

kampionit aktual Golden Eagle Ylli.

Indeksin më të lartë të prizrenasit e kishin Wayne Arnold dhe Ivan Koljeviq. Arnold ndeshjen e përfundoi me 28 pikë, nëntë kërcime dhe një asistim, kurse Koljeviq me 17 pikë, shtatë kërcime dhe 13 asistime. Bashkimi shënoi fitoren e dytë në këtë edicion, duke mundur Rahovecin. Te prizrenasit lojtarët më të dalluar ishin Daniel Lekndreaj me 15 pikë, 11 kërcime dhe katër asistime, si dhe Altin Morina me 22 pikë, pesë kërcime dhe katër asistime.

TOP PESËSHJA

Rodney Purvis (Peja) 30 pikë, 3 kërcime, 4 asistime
Wayne Arnlod (Ponte Prizreni) 28 pikë, 9 kërcime, 1 asistim
Ivan Koljeviq (Ponte Prizreni) 17 pikë, 7 kërcime, 13 asistime
Daniel Lekndreaj (Bashkimi) 15 pikë, 11 kërcime, 4 asistime
Altin Morina (Bashkimi) 22 pikë, 5 kërcime, 4 asistime

Vllaznia në grup me Chelsean, PSG-në dhe Realin

Nyon, 3 tetor - Vllaznia e femrave debuton për herë të parë në Ligën e Kampionëve duke u bërë e para skuadër shqiptare për femra që e arrin këtë sukses. Të hënën skuadra shkodrane ka njohur rivalet që do të ketë kundër në fazën në grupe, pas shortit të hedhur në Nyon të Zvicrës. Kundërshtarët e

GRUPET E LIGËS SË KAMPIONËVE

Grupi A: Chelsea, PSG, Real Madrid, Vllaznia
Grupi B: Wolfsburg, Sllavia Prague, St. Polten, Roma
Grupi C: Lyon, Arsenal, Juventus, Zurich
Grupi D: Barcelona, Bayern Munchen, Rosengard, Benfica

saj do të jenë Chelsea, PSG dhe Real Madridi në grupin A, i cili mund të quhet dhe si grupi i ferrit.



FShF-ja mohon marrëveshje me Di Biaggion: Kemi trajner Rejën

Tiranë, 3 tetor - Federata Shqiptare e Futbollit ka reaguar në lidhje me zërat për një akord të FShF-së me trajnerin italian Luigi Di Biaggion që të jetë trajner i kombëtares shqiptare.

“Zërat kanë qarkulluar orët e fundit në lidhje me një marrëveshje të mundshme me Luigi Di Biaggion për drejtimin e ekipit të futbollit të Shqipërisë janë totalisht të pavërteta dhe

një spekulim i pabazë. Kombëtarja shqiptare e futbollit ka në drejtimin e saj trajnerin Edoardo Reja, i cili është ende nën kontratë dhe vazhdon punën e tij. Federata Shqiptare

e Futbollit bën me dije se fokusi ynë është te shorti i Kampionatit Evropian 2024, i cili do të hidhet me datë 9 tetor në Frankfurt”, thuhet në njoftimin e FShF-së.



Meriton Korenica, ‘ylli i javës’ në Superligë

PRISHTINË, 3 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ndarjen e çmimit “ylli i javës” pas çdo xhiroje në Albi Mall Superligë. Çmimi i më të mirit për javën e nëntë i ka takuar mesfushorin ofensivë të Ballkanit, Meriton Korenica. Komisioni vlerësoi se mesfushori kreativ ishte lojtari më i mirë i ndeshjes dhe njëherësh vendimtar në fitoren që skuadra kampione e realizoi para tifozëve të vet kundër Gjilanit (2:0). Ai shënoi golin e dytë për portokallezinjtë, në minutën e 88, duke e vulosur fatin e këtij takimi. Korenica u shpreh i lumtur që skuadra e tij u rikthye në ‘folenë’ e vet me fitore, teksa u shpreh i nderuar me çmimin “ylli i javës”. “Jam shumë i lumtur për këtë çmim, por edhe për golin dhe fitoren e shënuar. Shpresoj që gjatë këtij kampionati unë ose bashkëlojtarët e mi të rikthehemi sa më shpesh këtu për ta marrë çmimin e më të mirit të javës. FC Ballkani është në rrugën e duhur për ta mbrojtur titullin e kampionit dhe do të luftojmë ndeshje pas ndeshjes që të



shënojmë sa më shumë fitore dhe të dalim triumfues të Albi Mall

Superligës”, ka theksuar Korenica për faqen zyrtare të FFK-së.

Nadal: Nuk e di nëse do të luaj më këtë vit

MADRID, 3 TETOR - Viti 2022 ka qenë mjaft delikat, por edhe mjaft pozitiv për tenistin spanjoll Rafael Nadal, që nga dita e hënë do të jetë numri dy në botë. Ai triumfoi në Australian Open dhe Roland Garros, por shpesh dëmtimet e kanë penguar të ketë një sezon edhe më të mirë. Së fundi, për shkak të disa problemeve personale, ai u tërhoq nga turneu i Laver Cup, të nesërmen e sfidës me Roger Federer, ku luajtën së bashku në lojën dyshe. 36-vjeçari spanjoll pret të bëhet së shpejti baba për herë të parë në jetën e tij. E ardhmja e tij është ende në dilemë, nëse do të luajë me këtë sezon apo jo. Ai synon të jetë në turneun Masters të Paris dhe në finalen e ATP (Torino). “Këtë sezon kam menduar disa herë



tërheqjen. Madje mendoja se Roland Garros do të ishte sfida e fundit këtë vit”, ka thënë Nadal. “Këtë vit kam pasur mjaft probleme fizike. Këmba më ka penguar shumë, sidomos në

pjesën e parë të sezonit, më pas pata një tërheqje në Wimbledon dhe sërish në Nju-Jork. Para se të rikthehem kam nevojë të jem i qetë edhe psikologjikisht përveç anës fizike”, ka deklaruar Nadal.

SHKURT

Inzaghi mund të shkarkohet nga Interi

E ardhmja e trajnerit të Interit, Simone Inzaghi, mund të vendoset në nëntë ditët e ardhshme kur “Nerazzurët” do të përballen me Barcelonën dhe Sassuolon. “Zikaltrit” kanë pasur një fillim të tmerrshëm të sezonit me katër fitore dhe katër humbje në tetë ndeshje në Serinë A. Ata humbën dy sfidat e fundit radhazi kundër Udineses dhe Romës dhe tani janë nën presion përpara ndeshjes me Barcelonën në Ligën e Kampionëve. Sipas “La Gazzetta Dello Sport”, nëntë ditët e ardhshme mund të jenë vendimtare për të ardhmen e Inzaghi.

Suarezi, Haalandit: Je numri 9 më i mirë në botë

Luis Suarez ka bekuar me një koment Erling Haaland. Pas trigolëshit të sulmuesit norvegjez në derbin e Manchesterit, sulmuesi uruguaiian e uroi atë në “Instagram”. “Urime miku im! Ndashje e shkëlqyer për ty! Je numri 9 më i mirë për momentin”, ishin fjalët e ish-sulmuesit të Barcelonës.

Lewandowski: Për ofertën e Barcelonës nuk u mendova dy herë

Robert Lewandowski ka folur në lidhje me transferimin e tij te Barcelona. Sulmuesi ka thënë se kur Barça e telefonoi, ai nuk mendoi dy herë për t'i thënë po ofertës. “Real Madridi ishte interesuar për mua në disa raste, por kur Barcelona më thirri, nuk u mendova dy herë. E dija që klubi nuk ishte në momentin më të mirë, por gjithmonë kam menduar për të ardhmen. Barcelona do të jetë sërish ndër më të mëdhenjtë”, ka thënë Lewandowski.

Ancelotti: Barazimi na trishtoi, por do të rikthehem shpejt

Real Madridi ka bërë gabimin e parë këtë sezon në La Liga, pasi është ndalur nga Osasuna në barazim 1-1. Ishte ky barazimi i parë i madrilenëve pas gjashtë fitoreve radhazi në kampionat dhe tani ndajnë pozitën e parë me Barcelonën. Carlo Ancelotti ka folur pas këtij barazimi duke thënë se nuk bën një lojë me ritëm të lartë, por e meritonin të fitonin. “Loja në përgjithësi nuk kishte një ritëm shumë të lartë. Nuk ishte një ditë e mirë për ne, por meritonim të fitonim. Ndashja nuk shkoj ashtu siç do të donim, por nuk duhet të justifikohemi. Skuadra kishte bërë shumë mirë deri tani dhe një barazim si ky ndaj Osasunës futet te gjërat që ndodhin gjatë një kampionati. Sigurisht që duhet të përmirësohemi. Askush nuk është i gëzuar kur Reali nuk fiton, barazimi na trishton, por do të reagojmë shpejt”, ka thënë Ancelotti. “Lëndimi i Courtois nuk është i rëndë, por ta shohim rezultatin e analizave. Penalltia? Mendova ta ndërroj goditësin, por Karim ekzekutoi dy penalltitë më të mëdha sezonin e kaluar. Ai është goditësi më i mirë që kemi”, ka shtuar Ancelotti.

Keane: Unitedi nuk po e respekton Ronaldon

Manchester Unitedi pësoi një humbje të thellë 6-3 ndaj Manchester Cityt në derbin e Manchesterit teksa Cristiano Ronaldo e shikonte nga stoli ndeshjen

në “Etihad”. Legjenda e United, Roy Keane, ka thënë për “Sky Sports” se ish-skuadra e tij nuk po e respekton Ronaldon. “Manchester Unitedi duhet

ta kishte lënë Ronaldon të largohej nga klubi këtë verë. Ata nuk e respektojnë atë. Nëse shikoni rekordin e golave të tij, ai ka po aq shanse të shënojë sa çdo

lojtar tjetër. Ai është një nga lojtarët më të mirë të të gjitha kohëve dhe nëse ai qëndron javë pas javë në bankinë, nuk është mirë. Duhet ta kishin lënë të ikte

kur ishte rasti. Ai kishte opsione, unë e di këtë në fakt, dhe mbajtja e tij në ekip për ta lënë në stol më duket qesharake për një lojtar si ai”, ka thënë Keane.



**Kuzhina
Qendrore**

Ndërmarrje publike lokale | Rr. Egnatia p.n. - 10 000 Prishtinë | www.kuzhina.net | kuzhinaqendrore@gmail.com | tel: + 383 45 709 106

NJOFTIM

PËR ANULIMIN E POZITAVE TË KONKURSIT PUBLIK TË DATËS 12.09.2022

Komisioni i Përzgjedhjes gjatë procedimit të të dhënave për konkursin e shpallur me datën 12.09.2022 për vendet e lira të punës, ka konstatuar se në disa pozita nuk janë plotësuar kushtet e parapara ligjore për të vazhduar më tutje me procedurat e konkursit.

Procesi i rekrutimit është anuluar sepse nuk janë plotësuar kushtet ligjore për të vazhduar procedurat e konkursit, përkatësisht nuk është plotësuar kushti ligjor duke mos pasur kandidatë të mjaftueshëm (së paku 3 kandidatë), me kualifikime përkatëse sipas Udhëzimeve Administrative në fuqi.

Kryeshefi Ekzekutiv



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "RAJ D SLEEPERS" D.O.O. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811396846 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "RAJ D SLEEPERS" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811396846 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "RAJ D SLEEPERS" D.O.O. has come to the decision to quit its business: 811396846 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Enver Peci shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinë "Hasan Prishtina".

- Rima Engineering Group" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-sw, me nr 330270116.

- Marjeta Laksi nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII të SH.M. Mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.

- Sabri Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f. "Shaban Golaj" Lipovec Gjakovë.

- Flora Xhuli nga Juniku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X, XI, XII të gjimnazit "Edmond Hoxha" Junik.

- Masters BR-DOO. Shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr Unik Identifikues 811935230.

- Blerim B. Bajrami B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit individual me emrin tregtarë D.P.Z. Auto Ngjyrosës "Buli" me nr. Unik 810934580.

- "Trend Shped" SH.P.K. shpall të pavlefshme Polica e sigurisë së kamionit TPL 0009532850 TPL PLUS 0002214215.

- Shield Recruitment&HR SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811277343

- Hana Nuha shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme të vitit I, II, III me nr: 1130 të vitit 2000, 1594 të vitit 2001 si dhe 2128 të vitit 2002 drejtimi Elektro Teknik "Naim Frashëri".

- Larta Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Njëmbëdhjetë të Gjymnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Kolë Vokrraj nga Novosella e Epërme kk Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Kushtrim Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjymnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

